



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 22 mars 2024
Kodi i ZRRE-së: V_1921_2023

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Mbështetur në e Nenin 9, paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Nenit 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe 1.5, Nenit 25, Nenit 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, ë Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084), Vendimin V_1766_2023 të datës 21 shtator 2023, dhe kërkesën e Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike – ALPEX., për zgjatjen e afatit për miratimin e Listës së Tarifave të ALPEX sh.a., për zonën e ofertimit të Republikës së Kosovës dhe si Operator i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), të datës 31 korrik 2023,

në seancën e mbajtur më 22 mars 2024 nxori këtë:

V E N D I M

- APROVOHEN** – Vazhdimi i afatit të aplikimit të tarifave të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike (ALPEX SH.A.) për zonën e ofertimit të Republikës së Kosovës.
- OBLIGOHET** - Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike (ALPEX SH.A) që deri me 31 maj 2024 të dërgojë Metodologjinë për Përcaktimin e Tarifave të Bursës për shqyrtim dhe miratim në ZRRE.
- OBLIGOHET** – ALPEX SH.A., që deri në përcaktimin e metodologjisë për përcaktimin e tarifave të ALPEX, tarifave të njëjta do të aplikohen edhe për Operatorin e Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) për kryerjen e Aktiviteteve të Ndërlidhura me Bashkimin e Tregut të një dite para dhe ndërditor dhe Operimin e Tregut të Bashkuar për territorin e Republikës së Kosovës.
- Struktura e tarifave të ALPEX është dhënë në tabelën e mëposhtme, dhe termet e përdorura e kanë kuptimin e njëjtë me ato që aplikohen nga ALPEX SH.A:

Tarifat e aplikueshme	Pagesa e Tarifës	Niveli	Paguhet nga
Tarifë administrative	Një herë	€ 200	Anëtarët e bursës
Tarifë hyrëse për anëtarët e bursës	Një herë	€ 7,000	Anëtarët e bursës
Tarifë për qasje për Anëtarë Kliringu	Një herë	€ 5,000	Anëtarët e kliringu
Tarifë vjetore për Anëtarë të Bursës	Vjetore	€ 10,000	Anëtarët e bursës
Tarifë vjetore për Anëtar Direkt Kliringu	Vjetore	€ 2,000	Anëtar kliringu
Tarifë vjetore për Anëtarë Kliringu	Vjetore	€ 6,000	Anëtarë kliringu
Tarifë tregtimi për MWh	Ditore	€ 0.07	Anëtarët e bursës
Tarifë kliringu për MWh	Ditore	€ 0.02	Anëtarët e bursës
Tarifë tregtimi për palë të treta	Për urdhër	€ 20	Anëtarët e bursës
Tarifë për përdorues API	Vjetore	€ 2,000	Anëtarët e bursës
Mirëmbajtje e llogarisë për Anëtar Direkt Kliringu	Mujore	€ 100	Anëtarë kliringu
Menaxhim i letrave garantuese	Kur depozitohen	€ 50	Anëtar kliringu
Tarifë vjetore për trajnime	Vjetore	€ 200	Anëtarët e kliringu dhe bursës
Tarifë për provim	Vjetore	€ 100	Anëtarët e kliringu dhe bursës
Certifikatë digjitale për përdoruesit	Vjetore	€ 50	Anëtarët e kliringu dhe bursës

- Tarifat duhet të publikohen në faqen zyrtare të ueb-it www.alpex.al.
- Ky vendim zbatohet për zonën ofertuese të Republikës së Kosovës deri në shqyrtimin e ardhshëm e të tarifave të ALPEX.





ARSYETIM


- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 2 shkurt 2024 nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike (ALPEX SH.A) ka pranuar kërkesën për zgjatjen e afatit për miratimin e Listës së Tarifave të ALPEX sh.a., për zonën e ofertimit të Republikës së Kosovës dhe si Operator i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO).
 - ZRRE vlerëson se vazhdimi i afatit për aplikimin e tarifave duhet të jetë deri në rishikimin e ardhshëm të tyre, pasi që ALPEX të dërgoj për shqyrtim Metodologjinë për përcaktimin e tarifave të ALPEX, e cila duhet të përgatitet dhe dërgohet në ZRRE deri me 31 maj 2024.
 - Bordi i ZRRE-së, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të kërkesës për zgjatje të afatit për miratimin e Listës së tarifave të ALPEX sh.a., duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.
- VII.** Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- VIII.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së.


Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të inicioj konflikt administrativ në gjykatën kompetente, tridhjetë (30) ditë, nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.


Bordi i ZRRE-së:


Ymer Fejzullahu, Kryesues


Lutfije Dervishi, anëtare


Gani Buçaj, anëtar


Arta Isufi, anëtare


Adnan Prehiqi, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- ALPEX,
- KOSTT, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.